



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS**  
**REKTORI**  
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV/PROTOKOLLIT**

Tiranë, më 21.11. 2022

Lënda : Njoftim për shpallje konkursi për 3 (tre) pozicione pune në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit.

**DREJTORISË SË ZHVILLIMIT TË PROGRAMEVE DHE DIXHITALIZIMIT TË**  
**SHËRBIMEVE AKADEMIKO-SHKENCORE**  
**KËTU**

Universiteti i Sporteve të Tiranës, bazuar në Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UST-së, si dhe në vendimin e Rektorit të UST-së, shpall kriteret për punësimin e 3 (tre) vëndeve të lira pune për personel akademik kërkues-shkencor **“Lektor”** dhe **“Asistent Lektor”**, pranë Institutit të Kërkimit Shkencor të Sportit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

- I. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës si **“Lektor”** me kohë të plotë në Departamentin e Projekteve dhe Teknologjisë në fushën e kërkimit: **“Shkenca Sociale-Marrëdhënie Ndërkombëtare/Shkenca të Komunikimit për Aktivitetin Fizik dhe Sportin”**, si më poshtë;

**Kritere të përgjithshme:**

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore **“Doktor”**.  
(Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Kandidati të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
3. Kandidati të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kandidati të mos ketë prishur imazhin e UST-së.
5. Kandidati të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

**Kritere specifike:**

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në Shkencat Sociale, Shkenca Politike ose Marrëdhënie Ndërkombëtare.

2. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
3. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
4. T'i përkasë kategorisë së kërkuar të personelit.
5. Të ketë tregues në specializimin/kualifikimin përkatës.
6. Të ketë tregues sipas kriterit të arritjeve akademike.
7. Të ketë përvojë në mësimdhënie dhe/ose specializim në fushën e kërkuar.
8. Të ketë përvojë kërkimore në fushë.
9. Të ketë eksperiencë me projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

**Kritere preferenciale:**

1. Të ketë përvojë pune me kohë të plotë ose të pjesshme në arsimin e lartë sipas përcaktimit në kritere.
2. Të plotësojnë kriterin specifik profesional të departamentit.
3. Të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor në UST.

- II. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës si **“Asistent Lektor”** me kohë të plotë në Departamentin e Projekteve dhe Teknologjisë në fushën e kërimit: **“Edukimi Fizik, Sportet e Aventurës/Turizmit Sportiv”**, si më poshtë;

**Kritere të përgjithshme:**

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
2. Të zotërojë së paku diplomë të ciklit të dytë, Master i shkencave ose ekuivalent me të, në fushën e kërkuar. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
3. Kandidati duhet të ketë notë mesatare të studimeve Bachelor dhe Master i Shkencave ose ekuivalent me të mbi 8.
4. Kandidati duhet të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 gjuhët e Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht).
5. Kandidati të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
6. Kandidati të mos ketë prishur ose dëmtuar imazhin e UST-së.
7. Kandidati të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

**Kritere specifike :**

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në Shkencat Sportive.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. T'i përkasë kategorisë së kërkuar të personelit.
4. Të ketë tregues në specializimin përkatës.
5. Të ketë tregues sipas kriterit të arritjeve akademike.
6. Të ketë përvojë në fushën e sporteve të aventurës dhe turizmit sportiv.
7. Të ketë eksperiencë me projekte në fushën e turizmit dhe të aventurës brenda ose jashtë Shqipërisë.

**Kritere preferenciale:**

1. Të ketë përvojë pune me kohë të plotë ose të pjesshme në arsimin e lartë sipas përcaktimit në kritere.

2. Të plotësojnë kriterin specifik profesional të departamentit.
3. Të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor në UST.

III. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme për pozicionin e punës si **“Lektor”** me kohë të plotë në Departamentin e Aktivitetit Fizik dhe Shëndetit, në fushën e kërkimit: **“Aktiviteti fizik dhe shëndeti dhe zbatime të tij në fushat e rekreacionit dhe sportit”**, si më poshtë;

#### **Kritere të përgjithshme:**

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën gradën shkencore “Doktor”.
  - i. (Grada shkencore e mbrojtur në institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
2. Kandidati të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
3. Kandidati të përmbushë kriteret që përcaktohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
4. Kandidati të mos ketë prishur imazhin e UST-së.
5. Kandidati të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

#### **Kritere specifike:**

1. Të ketë mbaruar studimet e larta në Shkenca Mjekësore, ku parapëlqehen drejtime të Shkencave Mjekësore Teknike, me fushë specifike në Teknikë Laboratori.
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
3. T’i përkasë kategorisë së kërkuar të personelit.
4. Të ketë tregues në specializimin/kualifikimin përkatës.
5. Të ketë tregues sipas kriterit të arritjeve akademike.
6. Të ketë përvojë në mësimdhënie dhe/ose specializim në fushën e kërkuar
7. Të ketë përvojë kërkimore në fushë.

#### **Kritere preferenciale:**

1. Të ketë përvojë pune me kohë të plotë ose të pjesshme në arsimin e lartë sipas përcaktimit në kritere. Preferohen kandidatët që mbajnë gradë ose titull akademik.
2. Të plotësojnë kriterin specifik profesional të departamentit.
3. Të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor në UST.

#### ➤ **Vlerësimi i Intervistës:**

- Në aftësitë shprehëse për mënyrën e paraqitjes së filozofisë së mësimdhënies nga ana e kandidatit.
- Prezantimin në ppt dhe referimin e një teme që lidhet me fushën, specialitetin, lëndën që ai pretendon të mbulojë (mini – leksion).
- Të jetë i gatshëm t’i përgjigjet pyetjeve të ndryshme rreth fushës së studimit.
- Kandidati duhet të jetë i përgatitur që mund të intervistohet edhe në gjuhën të cilën ai ka të certifikuar në aplikim.

- Vlerësimi i Kandidatit në Total është me 100 pikë, 30 pikë nga Intervista dhe 70 pikë nga kriteret e përcaktuara.
- Kandidati që shpallet fitues duhet të fitojë 50 (pesëdhjetë) pikë e lartë.

#### **IV. Kandidatët që do të aplikojnë për këto vende pune duhet të dorëzojnë këto dokumenta:**

- Mbushja e aplikimit (formulari tip) dhe firmosja e tij në cdo faqe, të cilën e shkarkoni nga Web-siti i UST-së.
- Shprehje e interesit nga ana e kandidatit me shkrim për plotësimin e vendit vakant duke shprehur në të edhe vizionin e tij për këtë pozicion.
- Biografi e punës mundësisht me eksperiencat që lidhen me vendin e punës për të cilin aplikon kandidati.
- Kopje e noterizuar e diplomës/ve dhe listës/ve të notave. (Diploma e lëshuar nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jetë njohur dhe njëhsuar paraprakisht nga Ministria përgjegjëse për Arsimin në Shqipëri).
- Dokumentacionin shoqërues përkatës të nevojshëm original ose të noterizuar, sipas plotësimit të kriteve të shpallura.
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) ose formulari i vetëdeklarimit.
- Letra rekomandimi nga profesorë të fushës.
- Fotokopje të dëshmive të kualifikimeve të ndryshme, të noterizuara.
- Listë të punimeve shkencore të publikuara në revista ndërkombëtare profesionale/shkencore dhe/ose punime të tjera, pjesëmarrje në referime shkencore, në konferenca etj; ( mundësisht linku i artikullit ose conferences. ISBN ose ISSN të artikujve ose botimeve).

#### **IV. Mënyra e dorëzimit të dokumentacionit**

Dokumentacioni i plotësuar sipas kriteve të shpallura të konkurrimit në njoftimin publik dhe në faqen e UST-së, mund të dorëzohet on-line në e-mailin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit ([lshehu@ust.edu.al](mailto:lshehu@ust.edu.al)) ose me postë sipas afateve të shpallura:

- Në rastin e aplikimit online në faqen zyrtare të UST-së, kandidati është i detyruar që të dorëzojë edhe fizikisht dosjen e tij të aplikimit ditën që do të ftohet për intervistë nëse kalon fazën e parë të aplikimit.
- Kandidati nuk mund të paraqesë asnjë dokument tjetër shtesë përveç atyre që ka aplikuar on-line në web-site të UST-së, (në e-mailin e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Arkiv Protokollit)
- Dokumentacioni i dorëzuar me anë të shërbimit postar dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të këtyre kandidatëve.

#### **V . Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët**

- Afati i dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët është 10 (dhjetë) ditë pune nga data e publikimit të njoftimit në faqen e UST-së dhe APP.
- Në zarf duhet të shënohet adresa e saktë e aplikimit; Universiteti i Sporteve të Tiranës, Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit dhe departamenti ku konkurron.
- Mosparaqitja e saktë dhe e qartë e këtyre të dhënave përbën shkak për mospranimin e paketës së konkurentit.

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE ARKIV/PROTOKOLLIT**